

KËSHILLI I EUROPËS

Strasbur, 27 nëntor 2003

CCJE (2003) Op.Nr.4

KËSHILLI KONSULTATIV I GJYQTARËVE TË EUROPËS (CCJE)

OPINIONI Nr. 4

I KËSHILLIT KONSULTATIV TË GJYQTARËVE TË EUROPËS (CCJE)

DREJTUAR KOMITETIT TË MINISTRAVE TË KËSHILLIT TË EUROPËS PËR TRAJNIMIN ADEKUAT FILLESTAR DHE TRAJNIMIN GJATË SHËRBIMIT, PËR GJYQTARË NË NIVELIN KOMBËTAR DHE EUROPIAN

Hyrje

Në një kohë, kur jemi dëshmitarë që një vëmendje çdo herë më e madhe po i kushtohet rolit dhe rëndësisë së gjyqësorit, i cili konsiderohet garancia përfundimtare e funksionimit demokratik të institucioneve në nivelin kombëtar, european dhe ndërkombëtar, çështja e trajnimit të gjyqtarëve të ardhshëm para se t'i marrin funksionet e veta gjyqësore, si dhe trajnimet e mëvonshme gjatë shërbimit, janë të një rëndësie të veçantë (shih Opinionin nr. 1 CCJE (2001), paragrafët 10. - 13 dhe Opinionin. Nr.3 (2002), paragrafët 25 dhe 50 ix).

2. Pavarësia e gjyqësorit nënkupton të drejtat e caktuara, të cilat u jepen gjyqtarëve në të gjitha nivelet dhe në të gjitha juridikcionet, por gjithashtu imponon edhe obligime të caktuara etike. Këto të fundit përfshijnë detyrën që puna në gjyqësor të kryhet me profesionalizëm dhe përkushtim, gjë që nënkupton që gjyqtarët duhet të kenë aftësi të posaçme profesionale, e cila fitohet, kultivohet dhe zgjerohet përmes trajnimeve që janë edhe detyrë, edhe e drejtë e tyre.

3. Thelbësore është që gjyqtarët, të cilët përzgjidhen pasi t'i kenë kryer të gjitha studimet e parapara juridike, të ndjekin një trajnim të hollësishëm, të thelluar dhe të larmishëm në mënyrë që jenë të gatshëm dhe të aftë t'i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të kënaqshme.

4. Një trajnim i tillë, gjithashtu paraqet garanci të pavarësisë dhe paanshëmërisë së tyre në pajtim me dispozitat e Konventës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

5. Përfundimisht, trajnimi është një parakusht që gjyqësori të jetë i respektuar, i vlerësuar dhe i denjë për një respekt të tillë. Besimi që qytetarët e kanë në sistemin gjyqësor do të jetë më i fuqishëm, nëse gjyqtarët pajisen me njohuri sa më të thella dhe gjithëpërfshirëse, që shtrihen përtej fushës të së drejtës dhe përfshijnë të gjitha fushat e rëndësishme me rëndësi shoqërore, si dhe të kenë aftësi të domosdoshme për të punuar në salla gjyqi, të kenë shkathtësi personale dhe mirëkuptim që ua mundëson atyre t'i menaxhojnë lëndët dhe të merren në mënyrë të drejtë dhe të kujdeshme me të gjitha palët në raste të tilla. Trajnimi, thënë shkurt, është i një rëndësie jashtëzakonisht të madhe për kryerjen e funksioneve gjyqësore në mënyrë objektive, të paanshme dhe me përgjegjësi, si dhe për mbrojtjen e gjyqtarëve nga ndikimet.

6. Ekzistojnë dallime të mëdha dhe të shumta në mes të vendeve europiane, sa i përket trajnimit të parë fillestar dhe atij të mëvonshëm, gjatë shërbimit të gjyqtarit. Këto dallime pjesërisht mund të jenë rezultat i veçantive të sistemeve të ndryshme gjyqësore, por në disa aspekte ato nuk duket të jenë të pashmangshme ose të domosdoshme. Disa prej vendeve ofrojnë trajnim formal të gjatë në institucione të specializuara për atë punë, pas të cilit pason trajnimi i mëtejshëm intenziv. Vendet e tjera, sigurojnë një lloj trajnimi të praktikantit nën monitorimin e një gjyqtari me përvojë, i cili është aty për t'i përcjellë njohuritë e veta dhe për të ofruar këshilla profesionale në bazë të shembujve konkretë, duke u treguar atyre cilën qasje ta zgjedhin duke iu shmangur çdo lloj didaktizmi. Vendet, sistemi ligjor i të cilave është themeluar në bazë të Të drejtës së përgjithshme (common law) mbështeten kryesisht në një përvojë të gjatë profesionale, zakonisht si avokatë. Në mes të këtyre mundësive, ekzistojnë një mori vendesh, ku trajnimi është organizuar në nivele të ndryshme dhe është i detyrueshëm.

7. Pavarësisht nga llojloshmëria e sistemeve kombëtare institucionale dhe problemet që paraqiten në disa vende, trajnimi duhet të shihet si diçka që është e një rëndësie thelbësore nga pikëpamja e nevojës për të përmirësuar jo vetëm njohuritë dhe aftësitë e atyre që gjenden në shërbim publik të gjyqësorit, por edhe funksionimin e vërtetë të një shërbimi të tillë.

8. Rëndësia e trajnimit të gjyqtarëve është e njohur në aktet ndërkombëtare, siç janë Parimet themelore të OKB-së për Pavarësinë e Gjyqësorit, të miratuara në vitin 1985, tekstet e Këshillit të Europës të miratuara në vitin 1994 (Rekomandimi Nr R (94) 12 për pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve) dhe 1998 (Karta Europiane mbi Ligjin për Gjyqtarët), dhe kësaj i referohet edhe në Opinionin nr. 1 CCJE, paragrafi 11.

I. E drejta për trajnim dhe niveli ligjor, në të cilin duhet të garantohet kjo e drejtë.

9. Me parimet Kushtetuese duhet të garantohet pavarësia dhe paanshmëria, prej të cilave varet legjitimiteti i gjyqtarëve, ndërsa gjyqtarët nga ana e tyre duhet ta sigurojnë ruatjen e nivelit të lartë përgjegjësive profesionale (shih paragrafin 50 (ix) Opinioni nr. 3 CCJE).

10. Në shumë vende, trajnimi i gjyqtarëve është rregulluar me rregullore të veçanta. Çështja thelbësore është që nevoja për trajnim të përfshihet në rregullat që e rregullojnë

statusin e gjyqtarëve; rregullat ligjore nuk duhet të merren detajisht me përmbajtjen e trajnimit, por kjo detyrë duhet t'i besohet një organi të veçantë, i cili do të jetë përgjegjës për hartimin e kurrikulumit, do ta sigurojë trajnimin dhe ta monitoroj zbatimin e tij.

11. Shteti është i obliguar t'ia sigurojë organit të pavarur gjyqësor ose ndonjë organi tjetër të pavarur që është përgjegjës për organizimin dhe monitorimin e trajnimeve me mjetet përkatëse si dhe t'ua mbulojë shpenzimet gjyqtarëve dhe të tjerëve të përfshirë në trajnim.

12. Prandaj, CCJE rekomandon që në çdo vend, në legjislacionin, i cili merret me statusin e gjyqtarëve, duhet të parashihet trajnimi gjyqtarëve.

II. Organi përgjegjës për trajnim

13. Karta Europiane për Ligjin për Gjyqtarë (paragrafi 2.3) thekson se çdo organ, që është përgjegjës për mbikëqyrjen e cilësisë së programit të trajnimit duhet të jetë i pavarur nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ dhe të paktën gjysma e anëtarëve të tij duhet të jenë gjyqtarë. Memorandumi shpjegues gjithashtu thotë se trajnimi i gjyqtarëve nuk duhet të kufizohet në trajnim teknik ligjor, por gjithashtu duhet ta kenë parasysh se natyra e thirrjes së gjyqtarit, shpesh kërkon nga gjyqtari të ndërhyjë në situata të ndërlikuara dhe të vështira.

14. Kjo e thekson rëndësinë kryesore që ka të bëjë me pavarësinë dhe përbërjen e organit përgjegjës për trajnim dhe përmbajtjen e tij. Kjo është pasojë e parimit të përgjithshëm të pavarësisë gjyqësore.

15. Trajnimi është një çështje me interes publik dhe pavarësia e organit përgjegjës për hartimin e planprogramit dhe vendosjen lidhur me atë se çfarë duhet të ofrojë trajnimi, duhet të ruhet.

16. Gjyqësori duhet të luajë rol të rëndësishëm, ose të jetë vetë përgjegjës për organizimin dhe monitorimin e trajnimit. Në përputhje me këtë dhe në pajtim me rekomandimet e Kartës Europiane për Ligjin për gjyqtarë, CCJE angazhohet që këto përgjegjësi në çdo vend duhet t'u besohen jo Ministrisë së Drejtësisë, ose ndonjë organi tjetër, i cili i përgjigjet pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ, por vetë gjyqësorit apo ndonjë organi tjetër të pavarur (përfshirë edhe Komisionin e gjyqtarëve). Asociacionet/shoqatat e gjyqtarëve gjithashtu mund të luajnë një rol të rëndësishëm në nxitjen dhe mundësimin e trajnimeve në bashkëpunim me organin gjyqësor, apo ndonjë organ tjetër që është drejtpërdrejt përgjegjës.

17. Që të sigurohet një ndarje adekuate e roleve, i njëjti organ nuk do të duhej drejtpërdrejt dhe në të njëjtën kohë të jetë përgjegjës edhe për trajnim, edhe për përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve. Prandaj, CCJE rekomandon që me autorizim të organit gjyqësor, apo ndonjë organi tjetër të pavarur, trajnimi t'i besohet një institucioni

të veçantë autonom që e ka buxhetin vetanak dhe i cili është aftësuar që, në bashkëpunim me gjyqtarët, të hartojë programe të trajnimit dhe të sigurojë implementimin e tyre.

18. Ata që janë përgjegjës për trajnim nuk do të duhej drejtpërdrejt të jenë përgjegjës për emërim dhe avancim të gjyqtarëve. Nëse organi (konkretisht, Komisioni i gjyqtarëve) të cilit i referohen edhe në Opinionin Nr. 1 CCJE, paragrafët 73 (3), 37 dhe 45) është përgjegjës për trajnim dhe emërim apo avansim, duhet të bëjë ndarje të qartë në mes të pjesëve të veta individuale, përgjegjëse për këto detyra.

19. Me qëllim që një institucion i tillë të mbrohet nga ndikimet e jashtme të papërshtatshme, CCJE rekomandon që stafi udhëheqës dhe trajnerët në atë institucion të emërohen nga ana e gjyqësorit, ose nga ana e ndonjë organi tjetër të pavarur që është përgjegjës për organizimin dhe monitorimin e trajnimit.

20. Është e rëndësishme që trajnimi të realizohet nga gjyqtarët dhe nga ekspertët e çdo fushe. Trajnerët duhet të zgjidhen në mesin e më të mirëve në profesionin e tyre, kurse organi përgjegjës për trajnimin duhet t'i zgjedhë me shumë kujdes, duke marrë parasysh njohuritë e tyre lidhur me lëndët që mësohen dhe aftësitë e tyre për mësimdhënie.

21. Kur gjyqtarët ngarkohen me aktivitete të trajnimit, është e rëndësishme që këta gjyqtarë të mbajnë kontakte me praktikën gjyqësore.

22. Metodatat e trajnimit duhet të përcaktohen dhe shqyrtohen nga organi përgjegjës për trajnime, për këtë arsye duhet të mbahen takime të rregullta të trajnerëve me qëllim që t'u mundësohet atyre t'i këmbëjnë përvojat e tyre dhe ta përmirësojnë qasjen e vet të trajnimit.

III. Trajnimi fillestar

a). A duhet të jetë i detyrueshëm trajnimi?

23. Ndonëse është e qartë se gjyqtarët, që janë rekrutuar në fillim karrierës së vet profesionale duhet të trajnohen, shtrohet pyetja a është kjo e domosdoshme, kur vetë gjyqtarët zgjidhen nga radhët e juristëve/avokatëve më të mirë, të cilët kanë përvojë, siç është (për shembull) në vendet, në të cilat sistemi ligjdhënës themelohet në Të drejtën e përgjithshme (Common law).

24. Sipas opinionit të CCJE, të dy grupet duhet ta ndjekin trajnimin fillestar; kryerja e punëve të gjyqarit është një profesion i ri për të dy grupet dhe përfshin qasje të veçantë në shumë fusha, veçanërisht, kur kjo ka të bëjë me etikën profesionale të gjyqtarëve, procedurën dhe raportet me të gjitha palët që janë të përfshira në procedurën gjyqësore.

25. Nga ana tjetër, është e rëndësishme të merren parasysh tiparet specifike të metodës së rekrutimit me qëllim që programet e trajnimit të zgjidhen dhe të përshtaten në mënyrë adekuate; juristët/avokatët me përvojë duhet të trajnohen vetëm në atë që është e domosdoshme për profesionin e tyre të ri. Në disa vende të vogla me gjyqësorë të vegjël, mundësitë lokale të trajnimit mund të jenë më të kufizuara dhe joformale, por këto vende mund t'i shfrytëzojnë mundësitë e trajnimit së bashku vendet e tjera.

26. Prandaj CCJE propozon trajnim të detyrueshëm fillestar sipas programeve që do t'u përshtaten përvojave profesionale të atyre që janë zgjedhur për pozita gjyqësore.

b) Programi i trajnimit fillestar

27. Planprogrami i trajnimit fillestar dhe intensiteti i trajnimit do të ndryshojë në masë të madhe në përputhje me metodën e zgjedhur për rekrutimin e gjyqtarëve. Trajnimi nuk duhet të përbëhet vetëm nga instruksionet lidhur me teknikat e përfshira në trajtimin e rasteve nga gjyqtari, por duhet gjithashtu të merret parasysh edhe domosdoshmëria e njohjes së vetë shoqërisë dhe aftësia e të kuptuarit gjithpërfshirës të çështjeve të ndryshme që reflektojnë në kompleksitetin e jetës në shoqëri. Përveç kësaj, hapja e kufijve do të thotë që gjyqtarët e ardhshëm duhet të jenë të vetëdijshëm që janë gjyqtarë europianë dhe duhet të jenë më të informuar për çështjet europiane.

28. Duke pasur parasysh shumëllojshmërinë e sistemeve për trajnimin e gjyqtarëve në Europë, CCJE rekomandon si në vijim:

i. që të gjithë ata që janë emëruar në pozita gjyqësore, para se t'i marrin detyrat e tyre, duhet të kenë, ose të marrin njohuri gjithpërfshirëse nga fusha e të drejtave dhe procedurave më të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare,

ii. që për programet e trajnimit që janë më specifike për kryerjen profesionit të gjyqtarit duhet të vendosë institucioni përgjegjës për trajnim, trajnerët dhe vetë gjyqtarët,

iii. që programet e tilla teorike dhe praktike nuk duhet të kufizohen në teknikat thjesht ligjore, por duhet të përfshijnë gjithashtu edhe trajnimin për etikën dhe hyrjen në fushat e tjera, relevante për veprimtarinë e gjyqtarit, siç është menaxhimi i rasteve dhe administrimi i gjykatave, teknologjia informative, gjuhët e huaja, shkencat shoqërore dhe zgjidhja alternative e kontesteve (ADR),

iv. që trajnimi duhet të jetë pluralist në mënyrë që të garantojë dhe fuqizojë mendjen e hapur të gjyqtarëve.

v. që, varësisht nga ekzistenca dhe kohëzgjatja e mëparshme e përvojës profesionale, kohëzgjatja e trajnimit duhet të jetë kuptimplote për t'iu shmangur reduktimit të tij në një formalitet të thjeshtë.

29. CCJE e rekomandon praktikën e caktimit të një periudhe të trajnimit, i cili do të jetë i përbashkët për profesione të ndryshme ligjore dhe gjyqësore (p. sh., juristët/avokatët dhe prokurorët në vendet, në të cilat ata kryejnë detyra të ndara nga ato të gjyqtarëve). Një praktikë e tillë ka gjasa të mundësojë njohje më të mirë dhe mirëkuptim të ndërsjellë ndërmjet gjyqtarëve dhe profesioneve të tjera.

30. CCJE vërejtë gjithashtu se shumë vende qasjen në vendin e punës për gjyqtar e kushtëzojnë me përvojën e mëparshme profesionale. Ndonëse një model i tillë nuk mund të zbatohet kudo dhe ndonëse miratimi i një sistemi, me të cilin kombinohen lloje të ndryshme të rekrutimit të gjyqtarëve gjithashtu mund të ketë përparësi, pikërisht në larminë e biografive të gjyqtarëve, është e rëndësishme që periudha e trajnimit fillestar, në rastin e kandidatëve që vijnë drejtëpërdrejt nga universiteti, duhet të përfshijë periudha substanciale të trajnimit në një mjedis profesional (praktikat e avokatëve, kompanive, etj.).

IV. Trajnimi në shërbim/në vendin e punës

31. Përveç njohurive themelore që duhet t'i fitojnë para se të marrin vendet e tyre, gjyqtarët janë "të dënuar të mësojnë dhe të fitojnë njohuri gjatë gjithë jetës" (shih raportoni R. Jansen "Si të përgatiten gjyqtarët që në vitin 2003, të jenë gjyqtarë të kualifikuar" doc. CCJE GT (2003) 3).

32. Trajnimi i tillë është bërë i domosdoshëm, jo vetëm për shkak të ndryshimeve në ligj, teknologji dhe njohurive që janë të domosdoshme për kryerjen e detyrave të gjyqtarit, por edhe për shkak të mundësive që u ofrohen gjyqtarëve në shumë vende për të fituar përgjegjësi të reja kur e marrin funksionin e ri. Prandaj, programet e trajnimit gjatë shërbimit duhet të ofrojnë trajnim në rast të ndryshimeve në karrierë, siç është transferimi nga gjykatat penale dhe civile, marrja e jurisdikcionit special (për shembull, në gjykatën familjare, gjykatën për të mitur, ose gjykatën e përgjithshme) dhe marrjen e postit, siç është kryesimi i trupit gjykues. Një transferim i tillë ose marrje e një përgjegjësie të tillë mund të kushtëzohet me ndjekjen e programit përkatës të trajnimit.

33. Ndonëse është e rëndësishme të organizohen trajnime shtesë gjatë shërbimit në vendin e punës, meqë shoqëria ka të drejtë të përfitojë nga gjyqtari i trajnuar mirë, është gjithashtu e domosdoshme të përhapet kultura e trajnimit në gjyqësor.

34. Nuk është reale që trajnimi gjatë shërbimit në vendin e punës të jetë i detyrueshëm në secilin rast. Ekziston frika se kështu trajnimi mund të bëhet çështje burokratike dhe të marrë thjesht karakter formal. Trajnimi i propozuar duhet të jetë mjaft tërheqës për gjyqtarët, t'i frymëzojë ata të marrin pjesë në të, sepse pjesëmarrja në baza vullnetare është garancia më e mirë e efikasitetit të trajnimit. Kjo gjithashtu duhet të mundësohet duke u siguruar që çdo gjyqtar të jetë i vetëdijshëm se është detyrë etike t'i ruajë dhe përmirësojë njohuritë e veta.

35. CCJE, në kontekst të një trajnimi të vazhdueshëm, gjithashtu e inkurajon bashkëpunim me organet e tjera juridike e profesionale që janë përgjegjëse për trajnim të vazhdueshëm, në çështjet me interes të përbashkët (p.sh. legjislacioni i ri).

36. CCJE më tutje e thekson dëshirën për organizimin e trajnimeve të vazhdueshme gjyqësore në mënyrën, e cila do t'i përfshijë të gjitha nivelet e gjyqësorit. Sa herë që kjo është e mundur, nivelet e ndryshme duhet të përfaqësohen në të njëjtat seanca, duke u dhënë të gjithëve mundësinë e shkëmbimit të pikëpamjeve në mes tyre. Kjo mënyrë gjithashtu i mposht tendencat hierarkike, i mban të gjitha nivelet e gjyqësorit të informuara për problemet dhe shqetësimet e njëri-tjetrit dhe e mbështet një qasje më kohezive dhe të qëndrueshme në gjithë gjyqësorin.

37. Prandaj, CCJE rekomandon:

i. që trajnimi gjatë shërbimit, normalisht duhet të bazohet në pjesëmarrjen vullnetare të gjyqtarëve.

ii. që trajnimi i gjyqtarëve gjatë shërbimit mund të jetë obligativ vetëm në raste të jashtëzakonshme; shembull, (nëse organi gjyqësor ose organi tjetër përgjegjës vendos kështu), mund të përfshijë rastet, kur gjyqtari merr një post të ri, ose një lloj tjetër të punës apo funksionit, ose në rast të ndryshimeve themelore në legjislacion.

iii. që programet e trajnimit duhet të hartohen nën autoritetin e organit gjyqësor, ose ndonjë organi tjetër përgjegjës për trajnimin fillestar dhe trajnimin gjatë shërbimit dhe nga trajnerët dhe vetë gjyqtarët.

iv. që ato programe, të zbatuara nën autoritetin e njëjtë, të jenë të fokusuara në çështje ligjore dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me funksionet që kryejnë gjyqtarët dhe u përgjigjen nevojave të tyre (shih paragrafin 27 të këtij teksti)

v. që vetë gjykatat duhet t'i inkurajojnë anëtarët e vet t'i ndjekin kurset e trajnimeve gjatë punës.

vi. që programet duhet të mbahen në një mjedis, ku anëtarët e degëve dhe niveleve të ndryshme të gjyqësorit mund të takohen, të këmbëjnë përvojat e tyre dhe të fitojnë njohuri përbashkëta.

vii. që megjithëse trajnimi është detyrë etike e gjyqtarëve, shtetet anëtare gjithashtu e kanë për detyrë t'ua vënë në dispozicion gjyqtarëve mjetet financiare, kohën dhe gjërat e tjera që janë të domosodshme për realizimin e trajnimeve gjatë shërbimit.

V. Vlerësimi i trajnimit

38. Me qëllim që në vazhdimësi të përmirësohet kualiteti i trajnimit gjyqësor, organet përgjegjëse për trajnim duhet të bëjnë vlerësime të shpeshta të programeve dhe metodave. Një rol të rëndësishëm në këtë proces duhet ta kenë mendimet e shprehura nga të gjithë pjesëmarrësit në trajnime fillestare, të cilat mund të nxiten nëpërmjet mjeteve të përshtatshme (siç janë përgjigjet në pyetësorë, intervistat).

39. Megjithëse, nuk ka asnjë dyshim që puna e trajnerëve duhet të monitorohet, vlerësimi i performancës së pjesëmarrësve në trajnimet fillestare gjyqësore është edhe më i diskutueshëm. Trajnimi i gjyqtarëve gjatë shërbimit mund të jetë vërtetë i frytshëm në qoftë se përfshirja e tyre e lirë nuk është e ndikuar nga arsyet që kanë të bëjnë me karrierën.

40. Në vendet që i trajnojnë gjyqtarët në fillim të karrierës së tyre profesionale, CCJE konsideron se vlerësimi i rezultateve të trajnimit fillestar është i domosdoshëm, me qëllim që në gjyqësor të emërohen më të mirët. Në të kundërtën, në vendet që i zgjedhin gjyqtarët nga radhët e juristëve/avokatëve me përvojë, metodat e vlerësimit objektiv aplikohen para emërimit, përmes trajnimit që realizohet vetëm pasi që kandidatët të përzgjidhen, kështu që në këto vende vlerësimi gjatë trajnimit fillestar nuk është adekuat.

41. Megjithatë, është e rëndësishme që në rastin e kandidatëve që i nënshtrohen një vlerësimi, ata duhet të gëzojnë mbrojtje adekuate ligjore që i mbron nga arbitratireti në vlerësimin e punës së tyre. Përveç kësaj, në rastin e atyre shteteve që organizojnë emërimet të përkohshme të gjyqtarëve, largimi i tyre nga funksioni në fund të periudhës së trajnimit duhet të bëhet duke i repsketuar masat mbrojtëse të aplikueshme për gjyqtarët kur largimi i tyre nga detyra është i paraparë.

42. Duke patur parasysh sa u tha më sipër, CCJE rekomandon si në vijim:

i. që programet dhe metodat e trajnimit t'u nënshtrohen vlerësimeve të shpeshta nga ana e organeve përgjegjëse për trajnime gjyqësore

ii. që, në parim, pjesëmarrja në trajnimin fillestar të gjyqtarëve nuk duhet t'i nënshtrohet vlerësimit cilësor; vetë pjesëmarrja e tyre, shikuar objektivisht, mund të merret parasysh në vlerësimin profesional të gjyqtarëve

iii. që cilësia e rezultateve të të trajnuarve megjithatë duhet të vlerësohet, nëse një vlerësim i tillë është i domosdoshëm për shkak të faktit se në disa sisteme, Trajnimi fillestar është fazë e procesit të rekrutimit.

VI. Trajnimi europian i gjyqtarëve

43. Cilado qoftë natyra e punëve të tyre, asnjë gjyqtar nuk mund ta injorojë Të drejtën europiane, qoftë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ose Konventat e tjera të Këshillit të Europës, ose sipas nevojës Traktatin e Bashkimit European dhe Legjislacionit, që dalin prej saj, sepse prej tyre kërkohet që ta zbatojnë drejtpërdrejt në rastet, në të cilat punojnë.

44. Me qëllim të promovimit këtij të aspekti esencial të detyrave dhe përgjegjësive të gjyqtarëve, CCJE konsideron se shtetet anëtare, pas intensifikimit të studimeve për Të drejtën europiane nëpër universitete, duhet ta promovojnë gjithashtu përfshirjen e tyre në programet e trajnimeve fillestare dhe trajnimeve gjatë shërbimit të propozuara për gjyqtarë, veçanërisht duke marrë parasysh zbatimin e tyre praktik në punën e përditshme.

45. CCJE gjithashtu rekomandon fuqizimin e Rrjetit europian për shkëmbimin e informacionit në mes personave përgjegjës për trajnimin e gjyqtarëve (Rrjeti i Lisbonës) i cili promovon trajnime për çështje me interes të përbashkët dhe nga fusha e të drejtës krahasuese, dhe ky trajnim duhet t'i plotësojë edhe nevojat e trajnerëve, edhe të vetë gjyqtarëve. Funksionimi i këtij rrjeti mund të jetë efikas vetëm në qoftë se e mbështetet secili shtet anëtar, sidomos nëpërmjet të krijimit të një organi përgjegjës për trajnimin e gjyqtarëve, siç përcaktohet në kreun II të këtij teksti, si dhe me ndihmën e bashkëpunimit paneuripian në këtë fushë.

46. Për më tepër, CCJE konsideron se bashkëpunimi në kuadër të nismave të tjera që kanë për qëllim afrimin e institucioneve trajnuese gjyqësore në Europë, në veçanti në kuadër të Rrjetit të trajnimit gjyqësor europian, mund të kontribuojë në mënyrë efektive në koordinim dhe harmonizim më të madh të programeve dhe metodave të trajnimit të gjyqtarëve në gjithë kontinentin.